

KOALICIONI PËR KOMRA

DRAFT STATUTI I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE TË KRIMEVE TË LUFTËS DHE SHKELJEVE TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË HAPËSIRAT E JUGOSLLAVISË SË DIKURSHME

Neni 11

Qëllimet e Komisionit

Komisioni ka këto qëllime:

- a) të vërtetojë provat (faktet) për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat në ish RSFJ, në periudhën nga 1 Janari të vitit 1991 deri me 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat shoqërore dhe politike të cilat kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të drejtave;

Tani do të vijmë te kategoria – viti i fillimit. Për ne 1990-ta. (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

- b) të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në shtetet kontraktuese të pranojnë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të drejtave të njeriut.
- c) Të kontribuojë në ndriçimin e fatit të humburve – pagjeturve;
- d) Të pranojë padrejtësitë e shkaktuara ndaj viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe dhembshuri për viktimat;
- e) Të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave; dhe
- f) Të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve dhe të shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut.

Neni 12

Detyrat e Komisionit

Komisioni ka këto detyra:

- a. të grumbulloj të dhëna për rastet e shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut dhe krimeve të luftës, të ofrojë përshkrimin detal për to, dhe të pasqyrojë përmes formularëve shkeljet e të drejtave dhe pasojat e tyre;
- b. të grumbullojë të dhëna për fatin e të humburve dhe të bashkëpunojë me trupat kompetente të cilat, në shtetet kontraktuese, merren me hulumtimin për të zhdukur;
- c. të bëjë inventarizimin e humbjeve njerëzore për:
 - i. civilët të cilët kanë humbur jetën ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;
 - ii. luftëtarët të cilët kanë humbur jetën, ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;

Nuk po e kuptoj pse për çfarë arsye KOMRA i ka marrë humbjet në njerëz, ky është obligim i shteteve të vërtetojnë se sa kanë njerëz të gjallë, sa kanë të vdekur, gjegjësisht të vrarë. Qëllimi kryesor i KOMRA-së është të hartojë listën e humbjeve në njerëz. Po e ritheksoj, **viktimat.** (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

Po e apostrofoj propozimin e Ljiljana Canjugas që të shkruhet „viktimat e krimeve të luftës”. Viktima duhet të vihet në fokus, dhe kjo është ajo që mua më mban për kaq kohë të gjatë, në tërë këtë çështje. (Veljko Vičević, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

- d. të grumbulloj të dhëna mbi vendet e burgosjes të ndërlydhura me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur, dhe të hartojë një regjistrim gjithëpërfshirës;
- e. [ALT. A: të hulumtoj rrethanat politike dhe shoqërore të cilat drejtpërdrejtë kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave, ose i formave të tjera të konfliktit të armatosur, si dhe kryerjes së krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut];
[ALT. B: të hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, duke filluar nga viti 1980, drejtpërdrejtë kanë sjellë deri te shpërthimi i luftërave ose formave të tjera të konflikteve të armatosura, si dhe kryerjen e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut];

(...) për ne është shumë me e rëndësishme të merret viti '74 kur janë bërë ndryshimet ligjore ne kushtetutat të cilat u kanë dhënë statut tjetër republikave, dhe u kanë dhënë (...) të drejtën për vetëvendosje për shkëputje. (Ljiljana Canjuga, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

Këtu, me shekuj ekziston procesi i demonizimit të palës tjetër. Sot shpesh dëgjoj, e posaçërisht gjatë luftës ka mund të dëgjohet – çka na kanë bërë në atë luftë. A do të duhej ndoshta të shkohet pak më larg në të kaluarën? (Nermin Karačić, Qendra për veprim paqësor, Sarajevë, BeH, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

- f. Që të mbajë dëgjime publike për krime të luftës dhe shkeljet e rënda të drejtave të njeriut,
- g. Të rekomandojë masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të drejtave të njeriut dhe për reparacionin për viktimat;
- h. Të hartoj, të publikojë dhe të prezantojë raport përfundimtarë.

Neni 14

Veprat në kompetencën e Komisionit

Krimet e luftës dhe shkeljet e rënda e të drejtave me të cilat merre Komisioni përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a. vrasjet;
- b. robërimi;
- c. burgosja e kundërligjshme;
- d. torturimi;
- e. humbjet e përdhunshme;
- f. deportimi dhe zhvendosja e përdhunshme e popullsisë;
- g. dhunimi dhe forma tjera të rënda të keqtrajtimit seksual;
- h. marrjen dhe shkatërrimin e pronës në përmasa të mëdha;
- i. marrja e talarëve;
- j. shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturo-historike;
- k. shfrytëzimi i civilëve dhe robërve të luftës si “mbrojtës të gjallë”.

(...) mendoj se ndoshta do të ishte më mirë të pranohet iniciativa e cila ka ardhur nga Bosnja e Hercegovina, që neni 14, të ndryshohet dhe të shkohet me (...) të gjitha shkeljet e të drejtës ndërkombëtare dhe shkeljet kundër njerëzimit. (Mirjana Bilopavlović, Delfin, Pakrac, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

Neni 21

Përbërja e Komisionit

Komisionin e përbëjnë 20 anëtarë dhe anëtare, me ç'rast:

- a. në Bosnje dhe Hercegovine zgjidhen 5 anëtarë/an[tare;
- b. në Republikën e Kroacisë, Republikën e Kosovës – Kosova/UNMIK, dhe Republikën e Serbisë zgjidhen nga 3 anëtarë/anëtare,
- c. në Mal të Zi, Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Sllovenisë, zgjidhen nga 2 anëtarë/anëtare.

(...) pse të mos shkohet me idenë që zëvendësi i anëtarit të zgjidhet me automatizëm. Kjo do të thotë se nuk do të konkurrojnë 20, por 40 persona dhe me këtë do ta zgjedhim problemin e kuoromit për punën e komisionit, Ndërsa vëllimi i punës është aq i madh, sa që të gjithë do të kenë shumë punë për të bërë. (Veljko Vičević, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

Neni 22

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit

1. Anëtari/anëtarja e Komisionit është:
 - a. Shtetas/shtetase e shteteve kontraktuese;
 - b. Person me kualitete të larta morale, me integritet dhe autoritet, i përkushtuar dialogut tolerant dhe konstruktiv për zgjidhjen e kontesteve, i cili mund të gëzojë besimin në të gjitha shtetet kontraktuese, dhe
 - c. Person me aftësi psiko-fizike për kryerjen efikase dhe në kontinuitet të detyrave të anëtarit/anëtares së Komisionit.
2. Shteti kontraktues zgjedhë më së paku një grua, gjegjësisht më së paku një burrë, për anëtarë ose anëtare të Komisionit.

Mendoj se këtë paragraf duhet thjeshtuar, duhet të theksohet qartë dhe thjeshtë se duhet të respektohet përfaqësimi gjinor. Me këtë thuhet e tëra. Ndërsa me këtë përcaktim, një femër apo një mashkull, me qëllim të detyrueshëm, mendoj se këto dallime nuk kanë vend në tekstin e statutit.

3. Shteti kontraktues, me rastin e zgjedhjeve të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit do të përkushtohet që të sigurojë edhe përbërjen reprezentative etnike të komisionit, në atë mënyrë që krahas pjesëtarit/pjesëtares nga radhët e Bashkësisë më të madhe në numër, do të mundohet që të zgjedhë edhe njërin/njërën ose më shumë pjesëtarë/pjesëtare nga bashkësia tjetër etnike, gjegjësisht nga bashkësitë tjera etnike në atë shtet kontraktues
4. anëtarë/anëtare e Komisionit nuk mund të jetë personi:
 - a. Që ka ushtruar funksion politik në dy vitet e fundit, para shpalljes së konkursit për zgjedhje të anëtarëve/anëtareve të Komisionit, ose në periudhën kohore e cila është përfshirë në kompetencën e Komisionit;
 - b. I cili (cila) ka qenë pjesëtar i strukturave ushtarake, policore, informative si dhe strukturave të tjera të sigurisë;
 - c. Për të cilin/cilën ekziston dyshimi i bazuar se është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, ose ka mbështetur, ndihmuar ose nxitur kryerjen e veprave të tilla, ose ka kontribuar në mos dënimin e atyre veprave, ose është në lidhje të ngushta me personin e gjykuar, akuzuar ose që është nën hetime për vepra të tilla.

(...) cili është ai trup apo organ i cili do ta vërtetojë integritetin e dikujt, autoritetin moral, etj? Ndërsa ata njerëz do të duhej të vërtetojnë faktet e krimeve të luftës sipas normave ligjore. Nuk është përshkruar profesioni [për komisioner]. (Željko Špelić, Oficer nderi Kroat, Pakrac, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

(...) të gjithë pikat e paragrafit 4, duhet të hiqen. (Veljko Vičević, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

(...) natyra e ime është kundër, që në një nen të flasim në mënyrë afirmative dhe joafirmative, të shprehem kështu. Sipas kësaj, tre paragrafët e parë të këtij neni na flasin për atë se kush mund të jetë anëtarë i komisionit, dhe parashtrohen kriteret e caktuara. Ndërsa në paragrafin e katërt nën pikat a), b) dhe c) flitet se kush nuk mund të jetë anëtarë i komisionit, gjegjësisht kush nuk mund të jetë anëtarë, dhe e tërë kjo është në nenin 22. Propozimi im është, nëse duam të mbesim pranë kriterëve përjashtuese, apo që dikujt t'ia pamundësojmë kandidimin apo propozimin për anëtarësim në atë organ, atëherë të formojmë një nen të ri, në të cilindo të parashtrohen dhe argumentohen qartë kriteret joafirmative apo përjashtuese, pra në nenin 22.a. E të mos jenë kështu të dyja së bashku. (Veljko Vičević, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

Neni 30

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Kuorumi për punë të Komisionit përbëhet nga 14 anëtarë/anëtares të Komisionit.
2. Komisioni bënë përpjekje që të gjitha vendimet e Komisionit ti nxjerr njëzëri, por kur konsensusi është i pamundur të arrihet, vendos me shumicën prej 14 anëtarëve/anëtareve.

Formulimi i pasaktë. Sa është shumica nga dyzet? Cila është kjo shumicë? Kemi thënë se nevojiten dy të tretat, këtë e kemi thënë në nenin 1., ndërsa në nenin 2. thuhet se vendosim unanimisht, apo me konsensus, me shumicë prej 14. Nuk kemi thënë se duhet të jetë 14 për, dhe këtu është një pasaktësi e cila mund të interpretohet në mënyra të ndryshme. Pra, duhet të ridefinohet (...) ky nen. (Veljko Vičević, UDVDR PGZ, Zagreb, Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

3. Komisioni mund të vendosë që për miratimin e vendimin procedural është i mjaftueshëm që të ekzistojë shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve dhe anëtareve.

Neni 42

Hartimi dhe publikimi i Raportit përfundimtarë

1. Para përfundimit të mandatit të vet Komisioni publikon Raportin përfundimtarë.
2. Komisioni dorëzon Raportin përfundimtarë kryetarëve/kryesisë së shteteve kontraktuese dhe, njëkohësisht i publikon (shpall) në të gjitha gjuhët zyrtare të shteteve kontraktuese.
3. Komisioni ka për obligim që njëkohësisht me dorëzimin e Raportit përfundimtarë të bëjë publik dhe të hapur rezyrenë e tij.

(...) në nenin 42; do të duhej harmonizuar, a duhet të jetë para pikës 1., në nëntitull, që raporti i komisionit duhet të jetë objektiv dhe i vërtetë. (Đorđe Gunjević, viktimë civile e luftës, Pakrac

Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

Neni 43

Përmbajtja e Raportit përfundimtarë

1. Raporti përfundimtarë përfshinë hyrjen, faktet relevante mbi krimet e luftë she shkeljen e rënda e të drejtave të njeriut, listën e humbjeve në njerëz, listën e personave të humbur, listën e vendeve për robërim, dhe rekomandimet.
2. Në mes tjerash, rekomandimet kanë të bëjnë me:
 - a. Hapat e mëtejme të shteteve nënshkruese drejtë përparimit të mirëbesimit në mes të shteteve dhe bashkësive në hapësirat e ish Jugosllavisë;
 - b. Modelin përkatës të reparacioneve materiale dhe simbolike, mënyrën për reformimin e institucioneve si dhe mekanizmat me të cilët sigurohet integriteti i fakteve të vërtetuara në sistemet e arsimit (edukimit) të shteteve kontraktuese;
 - c. Mënyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, dhe që mund të përfshijë edhe propozimin për themelimin e mekanizmit të veçantë për realizimin e qëllimit të tillë;

(...) në nenin 43., do të ishte mirë poqese këto rekomandimet kyçe të bëhen obligime për shtetet.

(Đorđe Gunjević, viktimë civile e luftës, Pakrac Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

Neni 44

Gjetjet mbi kryerësit

1. Komisioni ka autorizim që në Raportin përfundimtarë të vërtetojë se faktet e grumbulluara tregojnë për atë që personi i caktuar ka kryer krim lufte, gjegjësisht shkelje të rëndë e të drejtave të njeriut. Gjetja e tillë nuk ka efekt të aktgjykimit gjyqësor.

Dhe në nenin 44., një propozim konkret, në fillim shkruan “komisioni ka kompetencën”, propozoj që pas kësaj kompetence të shtohet “dhe obligimin” (Đorđe Gunjević, viktimë civile e luftës, Pakrac Kroaci, Konsultimet nacionale me bashkësitë lokale mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Pakrac, Kroaci, 22 tetor 2010)

2. Në raportin përfundimtar, Komisioni nuk mund të nxjerr gjetjet kundër ndonjë personi nëse nuk ka ndërmarr të gjithë hapat e arsyeshëm, që:
 - (a) Të njoftoj atë person lidhur me qëllimin e vet që të nxjerr gjetje jo të volitshme;
 - (b) Ti komunikojë personit përmbajtjen e gjetjes, të dhënat në bazë të të cilave nxirret gjetja, si dhe shkaqet në të cilat është bazuar gjetja e tillë, dhe
 - (c) Ti ofrojë personit mundësinë që në afat të arsyeshëm të përgjigjet në gjetjen e propozuar.

3. Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të akuzuarit, para Gjykatës ndërkombëtare ose vendore, Komisioni mundet në raportin përfundimtarë të udhëzojë në aktgjykimin përkatës.